



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik: *Banorët e Rajonit nr.4*

Data: 19.10.2022

Ora: 13.00

Vendi: *Salla e Këshillit Bashkiak Shkodër.*

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesëmarrësve 22, nga të cilat 5 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetari i bashkisë dhe anëtare e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon:

Hapja konsultimit nga Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

1. Arsimi baze parashkollor i Mesëm dhe i Përgjithshëm.

Përfaqesuese e gjimnazit “Kole Idromeno” nën drejtoresha e shkollës – Gjimnazi “Kolë Idromeno” ka një historik të gjatë të ndërtimit dhe funksionimit të saj, në të gjithë këto vite nuk ka asnjë investim. Përfshin edhe gjimnazin me kohë të pjesshme me nxënës nga Malësia e Madhe, Vau Dejes etj. Gjëndja infrastrukturës se kësaj shkolle është shume e keqe dhe megjithëse kemi bërë kërkesa në vite nuk është bërë asnjë investim. Asnjë nga nxënësit nuk arrin të kryej një proces mësimor të denjë.

1. Fillojmë që me oborin e shkollës që është në gjëndje shumë të keqe sapo të ketë një rreshje të vogël dhe detyrohemi të transportojmë edhe mësuesit nga oborri në shkollë me makine.
2. Nuk ka ambjente sportive.
3. Kemi problem me kopshtin që është prapa shkolle për infrastrukturën e dobët .
4. Nuk ka kabinete për mësuesit
5. Rrjeti elektrik është i amortizuar totalisht.

Kemi derguar shkresa dhe foto në Drejtorinë e Arsimit Shkodër. Kati i 4 nuk ka dyer apo dritare. I vetmi gjimnaz që akoma nuk është investuar dhe nuk ka asnjë rrugë zgjidhje akoma. Mendojmë që të gjithë nxënësit kanë të drejtën që të kenë kushte infrastrukturore te mira , ky është zëri edhe nga nxënësit i prindërve dhe stafit pedagogjik.

Kryetari – ka një procedurë në vijim për shkollën “Kolë Idromeno” po na sqaron edhe drejtori për situatën.

Ergys Ivziku – për sa përket gjimnazit “Kolë Idromeno” ne kemi bërë një aplikim pranë Ministrisë së Arsimit, por ai aplikim nuk u mor parasysh dhe nuk u miratua nga ministria, problematika qëndron në faktin që ky rikualifikim shkolle këkon një vlerë shumë të lartë investimi sipas standardeve prej 1 miliard lekësh të reja .Me parashikimin buxhetor të bashkisë Shkodër ne kishim planifikuar edhe bashkëfinancim ose ndërhyrje pjesore dhe kjo ndërhyrje normalisht është e pamjaftueshme.

Për shkollën “Kolë Idromeno” këtë vite jemi drejt vendosjes së stufave të drurit për të eliminuar ngrohjen me gaz. Nderkohë do të bëjmë takim me stafin pedagogjik për të gjetur dakortësi sa i përket investimit pjesor të kësaj shkolle sipas mundësive të bashkisë.

Benjamin Nako – Ju falenderoj për ftesën për të marrë pjesë në këtë dëgjësë. I perkas edhe une fushës së arsimit dhe problematika kryesore që dua të diskutoj

1. Rruga pranë Shkollës Speciale tek banja e vogël rruga (Arkitekt Sinani)
2. Qarkullimi i mjeteve dhe problematika që krijohet tek medreseja e vajzave sidomos gjatë orareve të mjesit dhe të drekës kjo krijon problem për të gjithë.

Jona Leqejza – kërkesë nga këshilltari e këshillit – A është finalizuar procesi i angazhimit të një stafi suport për shkollën speciale?

Ergys Ivziku – kam diskutuar për këtë pjesë edhe me keshilltaren ,struktura nuk ka nje pozicion të caktuar për të marre në pune nje person te ri si mesues mbështëtes.Mundësia që na mbetet për vitin tjetër është zëvendësimi i një personi që del në pension me një person të ri që kemi identifikuar.

Jona Leqejza – nqs kjo finalizohet me dakortesi jemi dakort dhe duhet të jetë edhe në buxhet;

1. A ka vlerë që në si këshill bashkiak të bëjmë një kërkesë apo miratim për shtim stafi në këtë institucion?

Ergys Ivziku – është një problematike e identifikuar dhe e vleresuar nga ana e jonë. Kemi dy mundësi ose te bëjmë zëvendësimin e personit qe del ne pension, ose te behet ndryshim strukture për vitin tjetër. Përmes zëvendësimit të personave që dalin në pension tek struktura e konvikteve.

Kryetari – të behët planifikim në pozicion për vitin që vjen në strukturë.

2. Menaxhimi i mbetjeve

Kryetari - Për mendimin tim ka një nevojë të jashtëzakonshme për përmirësim të shërbimit të pastrimit. Ka zona ku duhet të kemi vemendje të madhe sidomos ato me qëndra të mëdha apo supermarkete duke krijuar një problematike në qytet. Ka pasur përmirësime por akoma duhet të kemi kujdes dhe përmirësim të problematikave. Jemi shpesh edhe në konflikte ligjore me kompaninë e ofrimit të shërbimit të pastrimit megjithatë është edhe shumë e nevojshme që të kemi një ndërgjegjësim më të madh edhe nga ana e qytetareve Për këtë do te fillojme edhe një strategji mediatike me përfshirjen e mediave për të rritur ndërgjegjësimin. Për ne si bashki mbetet problem kryesor shërbimi i pastrimit shërbim me të cilin ne perballemi cdo dite dhe mundohemi që të mbajmë sipas standardit këtë shërbim. Ne lidhje me mbetjet në lagjen “Dracin” pranë nënstacionit – ka mungesë të kazanave dhe është shpesh e bllokuar edhe trotuari nga mbetjet. Jane blerë 100 kazana të rinj dhe do të jetë e mundur të shpërndahen në pikat e grumbullimit të mbetjeve ku ka nevojë.

Erkam Borici – ka nevojë që të krijohen xhepa për pikat e grumbullimit të mbetjeve edhe për problematikën e trafikut por edhe për vizibilitet. Pika e conadit ka nevojë për vemendje të shtuar sepse është gjatë gjithë kohës e mbushur .

Alfred Luleta – Dr. Sherbime publike – në lidhje me xhepat e kazanave kemi ndërtuar xhepa të tille sipas mundësisë së buxhetit. Jemi perqendruar ne Velipoje këtë vit ndërkohë që këtë vit do të ndërhyhet në qytet për të berë xhepa kazanash me mbulose dhe logo sensibilizuese. Në lidhje me supermarketet, kemi kontakte të vazhdueshme me to – në fillim të javës tjetër do të zhvillojmë një takim me këto supermarkete për të gjetur bashkëpunimin dhe koshat e dedikuar për këto supermarkete dhe planifikimin e frekuences së dedikuar vetëm për supermarketet. Ky është problem i identifikuar dhe jemi në proces për ta zgjidhur.

Kryetari – është bërë një inspektim këtë nje zonë pranë kalasë, kemi marrë kampionet dhe po procedojmë me penalizimin e këtij biznesi, pra pervec sensibilizimit ka edhe masa administrative. Janë kompani që kane nje fluks shumë të lartë mbetjesh dhe do të merremi seriozisht me zgjidhjen e kësaj problematike.

Muharrem Salja – banore lagjja Qafe - problem për ne është kanali i ujrave të zeza dhe të bardha që kalon në lagjen tone, nuk është bërë asnjë investim në këtë zonë dhe është shumë shqetësuese, të bëhet ndërhyrje.

Jemi me gropa septike në oborre dhe kjo problematike është shumë e madhe tashmë, shpesh duke krijuar edhe probleme midis banorëve. Të sillen një përfaqësues për të verifikuar situatën janë 150 metra rrugë që dalin te Xhamia e Plumbit është edhe zonë e frekuentuar nga turistët. Është bërë një pjesë investimi nga ana e kalasë dhe duhet plotësuar investimi edhe në këtë rrugë.

Kryetari - Në 2021 kemi bërë ndërhyrje në rrugën e Qafës dhe me patjetër do të vazhdojmë procedurën për mbylljen e këtij investimi deri në ri Kualifikimin total të saj. Do të dërgojmë inspektorët për të verifikuar këtë problematike.

3. Ndricimi dhe gjelberimi

Kryetari - kemi një projekt me SECO për sa i përket ndricimit publik ky projekt përfshin një pjesë të madhe të rajonit nr. 4, kemi bërë një shpërndarje në të gjithë qytetin. Do të fillohet me ndërrimin e ndricuesve me LED duke filluar nga Hotel Argenti deri tek shkolla pyjore. Jemi në përfundim të procedurave të tenderimit dhe para fillimit të këtij viti shpresojmë të fillojmë zbatimin duke dhënë impakt edhe në kursimin e energjisë duke e projektuar shkodrën si një qytet eficient energjie. Është një nga projektet më të rëndësishme për ne dhe për rajonin nr. 4

Banor i lagjes 4:

1. Kemi një problem me këtë rrugë ku shpesh ka edhe problem me përdorues të drogave dhe ka pasur edhe raste grabitjeje.
2. Duhet të shikohet mundësia për të mbyllur këtë rrugë, ndoshta mund të vendoset edhe një kamer .

Kryetari – do ta verifikojmë.

Moza, banore rruga Dervishbeg – kemi problem sa i përket fasadave të pallateve në këtë rrugë të gjitha pallatet janë që në ‘89 të ndërthuara dhe nuk ka pasur një investim në këtë zonë.

Tashmë nga këto pallate ka edhe aksidente sepse bijnë pjesë të sovitimeve apo ballkoneve në rrugë. E kemi diskutuar në vite këtë problematike dhe serisht dua ta shtroj si problematike. Jo vetëm estetikisht por edhe për sigurinë publike tone është me rëndësi të merret parasysh. Pavarësisht se jemi taksapagues nuk ka pasur investim për këto pallate.

Kërkojmë që taksat që paguajmë ne të investohen në zonën tonë dhe të merret në konsideratë rikonstrukcioni i këtyre fasadave.

Kryetari – është problematike e njohur dhe e vjetër për ne kjo edhe nga vjetërsia e ndërtimeve , është e domosdoshme për të ndërhyrë sidomos për rastet kur ka edhe rrezikshmëri publike. Është një vizion dhe politikë e qartë nga ana e bashkisë për të ndërhyrë jo vetëm estetikisht por edhe sa i përket eficiencës energjitike në pallatet e vjetra të qytetit ne e kemi filluar këtë ndërhyrje tek pallati i kinezëve për të orientuar Shkodrën si një qytet pilot për eficiencën energjitike.

Si pjesë e politikave tona mund të gjehet edhe mundësia e bashkëfinancimit për të rikualifikuar këto pallate, janë ide që duam 'ti zhvillojmë dhe do ta kemi prioritet. Ne vijojmë të paraqesim projekte për financim sa i përket rikualifikimit të pallateve sipas eficiencës energjitike dhe shpresojmë të gjejmë mbështetje nga donatorët.

Moza banore lagjja Dervishbeg – Lagjja nr. 1 : Është një tjetër problematik në Shirokë, për sa i përket pagesës së rrugës së mësuesve sepse kemi një kosto mujore prej 4 mijë lekësh për këtë transport. Ka një kosto prej 1 mijë lekësh të vjetra për transportin publik Shirokë - Zogaj dhe është e vështirë për tu përballuar nga ne që jemi buxhetor dhe përdorues të përditshëm të këtij transporti. Kam një ankesë ndaj anëtarëve të keshilli të bashkisë që kanë miratuar këtë tarifë.

Ergys Ivziku – janë dy probleme: Sa i përket problematikës së transportit dhe pagesës për mësuesit ka 5 vite që bashkia Shkodër nuk e ka këtë kompetencë për mësuesit. Për arsimin, transportin dhe subvencionimi i transportit të mësuesve bëhet nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Lezhë. Ato bëjnë tenderimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve dhe zbatohet nga ZVA Shkodër.

Jona Leqejza – këshilltare bashkiake – duhet të kemi parasysh që në dhjetor të vitit të kaluar është bere nje degjese me të gjithë operatorët e shërbimit publik ,kjo në kuadër të paketës fiskale dhe koston dhe si këshilltar ne e kemi pasur evidente problematikën e transportit publik si për mungesën e operatoreve në linja te caktuara por edhe për koston.

Është bërë një vleresim i koston së ofrimit të shërbimit publik dhe ka rezultuar që si transporti qytetas ashtu edhe Shirok -Zogaj janë kosto jo propocionale me cmimin e biletës. Vlera 120 lek te reja është kostoja reale për këtë shërbim dhe pavarsisht kësaj e subvencionojme dhe është 40 lek .Ndërsa sa i përket Shirok Zogaj kemi një frekuentim edhe me të ulët të përdoruesve dhe kjo ben edhe më të kushtueshme këtë shërbim. Duke qenë përpara zgjedhjes a të ofrohet apo jo kemi vendosur që të jetë në funksion dhe me këtë kosto të lartë. Shkodra ka 8 linja të miratuara por me koston e larta që ka privati nuk ka interes për ta ofruar këtë shërbim duke qënë se janë nën kosto. Kerkojmë të kemi edhe mirëkuptim me njeri- tjetrin për cdo vendimarrje. Kemi nje interesim për subvencionim të shtreses së invalideve dhe i njëjti interesim është bërë ndaj Zyres Rajonale të Arsimit duke qenë ato pergjegjës.

Alfred Luleta – e sqaroj edhe keshilltarja proceduren e transportit publik, sipas analizës së koston se bere është nje kosto e papërballueshme nga operatorët janë vendosur vetëm 2 frekuenca duke qënë se nuk ka përdorues te ketij shërbimi. Kete vit përfundojnë kontratat dhe ne synojmë të zgjerojmë shërbimin dhe do te shohim mundësinë për shtim të frekuencave.

Moza – shpresojmë që keshilli bashkiak të ndërhyje dhe të ketë një qasje positive për zgjidhjen e problematikave sidomos që prekin te ardhurat tona. Kudo ku shëtisim dhe shkojmë turistë bashkitë arrijnë të ofrojne një shërbim transporti me frekuenca shumë të shpeshta.

Sadeti Cungu – Banore lagje nr. 4 na shqeteson pranë shtepisë së oficerave , kemi 12 vite që është bërë projekti i rrugës dhe rruga është akoma e perealizuar. Ka problem me stolat e pedonale se Urës së Bunës, ato po demtohen cdo darkë nga njerez të papërgjegjshëm dhe duhet

të kemi vemendje sepse janë investime tonat. Gjithashtu kemi shkëputje të suvave në rrugët historike të qytetit , si p.sh pranë kafes së madhe.

Kryetari – Bulevardi Skenderbeg, Rruga e Jezuitve është e miratuar në këshillin bashkiak ky rikualifikim i kësaj rruge. Dhe do të vijojë procedura e investimit. Do të bejmë edhe verifikim nga ana e rajoneve. Problematika e prishjes dhe dëmtimit të investimeve publike ka të bëjë edhe me ndërgjegjësimin e banorëve e qytetarëve ka shumë punë për të bërë për këtë sensibilizim duke përfshirë edhe median por edhe të gjithë ne. Shërbimet publike duhet të verifikojnë këtë situatë.

Banor i lagjes: Korsia e bicikletave rruga Mehmet Pashe Plaku, ka shume frekuentim nga nxënësit dhe banorët dhe ka shume problem nga zënia e kësaj korsie.

Kryetari – edhe rruga e bicikletave është prioritet i punës tonë edhe për modelin që duam të japim si qytet i bicikletave por edhe për impaktin pozitiv në shëndetin tonë. Kemi vendosur në rikonstrukcion të rrugës së bicikletave rrugen nga Xhabija në Parrucë dhe uroj qe do të mund të shtrijmë edhe më shumë në qytet rrjetin e korsive te bicikletave. Do ta fillojmë me segmentin Xhabije- Parrucë me tendencën e qartë për ta zgjeruar edhe më tej këtë rrjet.

Jona Leqejza – që në 2019 në cdo mbledhje dhe degjesë publike është bërë evidente nevoja për planin e mobilitetit të Bashkisë Shkodër po ashtu do të kishte ndikim si lëvizjen me bicikleta por edhe të transportit publik. Duke pasur një plan mobiliteti do të kishim edhe një qasje më të gjerë ndaj afirmit dhe disiplinimit të lëvizshmerise në qytet. Duhet të kemi tarifim të parkingjeve dhe hapsirave publike.

Kryetari – plani i mobilitetit është pjesë dhe në perputhje me planin e mobilitetit por duke qenë të limituara mundësitë financiare për investime më të mëdha duam të fillojmë në këtë bulevard per të dhenë edhe një projekt pilot që do te vazhdoje me tej, duke i dhënë prioritet lëvizshmerisë me bicikleta. Jam dakort edhe për planin e tarifimit.

Po ashtu edhe vendosja e bume-ve, do të verifikojmë vendodhjen , ne kemi vendosur këto pengues të shpejtesisë pranë shkollave apo institucioneve, pikave kritike ku ka pasur levizshmëri të lartë

Sa i përket mbylljes së gropave është një problematike që jemi në dijeni kjo shpesh vonon për tu rikualifikuar sepse duke qenë se kemi sasi te vogla nevojë për asfalt kompanitë prodhuese nuk na furnizojnë sipas nevojës se vogël që kemi.

Banor i lagjes 4: U diskutua me parë rikualifikimi i zonës së pallatit të kinezve , vij si perfaqësues i bizneseve te zonës , dimë deri me tani që do te prishet hapësira publike të cilën në shfrytëzojmë , kemi bere dy takime dhe akoma nuk kemi një pergjigje perfundimtare se cfarë do të bëhet në këtë zonë dhe në bizneset tona.

Duke qënë se do të kërkohet të behët investim edhe nga ana e jonë a do të kemi një kontratë?

Kryetari – prandaj kemi vendosur që të kemi takime sa i përket këtij investimi , për termat se sa do te shfrytëzohet hapsira publike është serisht per tu dakortesuar, normalisht e gjitha do të bëhet në bazë të një kontrate.

Në rastin e këtij rikualifikimi është e domosdoshme që të kemi një rregull dhe investim të unifikuar edhe për katin e parë.

Benjamin Nako – është shumë e ndjeshme ceshtja e mobilitetit në qytetin tonë, na bën të ndihemi mire fakti që kemi një vizion tjetër bashkohor , gjithmonë brenda mundësive financiare së paku vizioni dhe prioritetet janë të ndryshme dhe positive. Është një dinamike tjetër e menaxhimit të qytetit. Është shqetesues edhe trafiku në bulevardin Zogu i parë nga trafik ndalueset e vendosura pranë shkolles “Ndre Mjeda” kjo krijon problem edhe për përdoruesit e bicikletave dhe duhet të rishikohet. Turistet që gjithashtu vizitojnë qytetin janë përdorues të bicikletave dhe bashkia duhet të ketë një strategji të mirëfilltë e të detajuar për t’ju përgjigjur kësaj kërkesë.

Kryetari – e mirëkuptoj diskutimin tuaj, kërkesa ka qenë e lartë nga qytetaret për shkak të afërsisë së shkollës “Ndre Mjeda” dhe riskut që mund të paraqesë. Në vendimarrjen që kemi bërë jemi orientuar për mbrojtjen e sigurisë së nxënësve dhe frekuentuesve të shkollës. Vizioni jonë do të jetë në të ardhmen eko-mobiliteti me përdorimin dhe krijimin e mundësive më të mira për levizshmërinë me bicikleta të cilën ne e kemi.

Tre prioritetet kryesore janë këto:

- 1- Eficienca
- 2- Mobiliteti
- 3- Teknologjia

Banor rajoni nr. 4, Fatmir Arishta – problem të madh kemi sa i përket rruges “Mehmet Gjyli” nuk është investuar asnjë herë, gjëndja është shumë e amortizuar dhe kërkojmë që të kemi investim meqenese kemi investuar në shtëpitë tona dhe duam të vijojmë jetën në këtë qytet. Nuk ka as rrjet KUZ as KUB.

Rruga është e ngushtë nuk ka mundësi të kaloj as zjarrfiksjat, rruga është zenë tashmë edhe nga ndërtime të leje dhe avullitë që kanë zënë rrugën.

Kryetari – Me patjetër situata që paraqisni kërkon nderhyrje të domosdoshme, jemi munduar që mundësitë e limituara financiare të investojmë në rrugët ku ka sa më shumë banorë apo rrugët që kanë flukse të larta trafiku. Megjithatë do të jetë në vëmendjen tonë prioritarë investimi në këtë rrugë.

Zënia e hapësirave publike është një tjetër konstatim që e vërejmë edhe në lagje të tjera dhe ka sjelle probleme të trashëguara tashmë duke ngushtuar rrugët apo reduktuar hapësirat publike. Nga ana e bashkisë është e vështirë që të bëhet një ndërhyrje kaq komplekse sa c’kërkohet megjithatë është në vëmendjen tonë.

Erjon Metushi , keshilltar keshilli bashkiak - Falenderoj pjesëmarrësit , kemi diskutuar sa i përket qendrave shëndetsore duke qenë edhe përfaqësues i komisionit që mbulon shëndetesinë ne kemi menduar që të krijojmë një komision të posaçem sa i përket nevojave që kanë qendrat shëndetsore sa i përket problemeve infrastrukturore që mbulon bashkia kjo për të pasur një qasje

tjetër dhe më specifike për këtë funksion. Sa i përket shërbimit mund të shprehen edhe banorët e pranishëm.

Kryetari i Bashkisë :

Duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërish dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë këto propozime të bëra sot këtu nga ana juaj.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema








BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.4

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Fioralba	Toma	F	24	Guri i Zi	Juriste	Projekti e Sigurkut. Specialist
2	Shivi	Drosini	M	28	SHKODER	Inspektor	Insp. Bashkia Shkoder
3	Fatmir	Arishto	M	55	SHKODER	Biznes	Furmece
4	Aben	Mullaci	M		SHKODER	Inspektor	B. Shkoder
5	Edmond	Sume	M	32	Shkoder	Inspektor	B. Shkoder
6	Arini	Bushadi	M	33	Shkoder	Biznes	Bor Coffe
7	Arifion	Risija	M	38	SHKODER	Polic	Polic. B.
8	Mustaferr	Lebë	M	69	Shkoder	Territor	Territorist
9	Osmond	Tofo	M	62	Shkoder	Printer	PA PDM
10	Zomir	Koloni	M	44	Shkoder	Teknik	Bushka
11	Bairben	Tuzi	M	31	SHKODER	Sipërnumar	Printer
12	Blerta	Scure	M	30	SHKODER	INSPEKTOR	DKSH
13	Gejza	Shepa	F	32	SHKODER	Policiere	Policia Bashkia

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.4

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	RAMETA	LOPÇI	F	32	SHKODËR	Administratore	B. SHKODËR
15	Blumozë	Gjerasani	F	58	Shkoder	me sere	Shkollë 9-vjeçare
16	Erkam	Bonici	M	30	Shkoder	me sere Inxhinier	B. Shkoder
17	Ridvan	Sokolli	M	62	Shkoder	Inxhinier	B. Shkoder
18	Beufamilly	Harbi	M	58	SHKODËR	PEDAGOG	U. "I. GURAKURDI
19	Ramona doçie	Mashkull	M	60	shkoder	Kalderisht	HPI TAL
20	Albana Nacia(Syfiq)		F	45	Shkoder	Nëndrejtoneshë	Gjinnazi Kolektor
21	Alfred Shkollë		M	46	Shkoder	Judist	B. Shkoder.
22	Jadedin Curry						

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK